



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR "VJOSË"

VENDIM

Nr. 9 Data 03.10.2017

Për mos miratimin e lejes së ujit , për ambalazhim në shishe ose në enë, burimi uJOR, “Burimi Pocemit”, Fshati-Pocem Bashkia Ballsh, Qarku Fier subjektit "ADBERT -07" Sh.pk., me administrator Z. Lefter Malaj

Në bazë të ligjit Nr.111/2012 datë 15.11.2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të V.K.M 416 datë 13.05.2015 "Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore", Formulari A/2 "Kërkesë për ujë për ambalazhim në shishe ose enë", Vendimit Nr. 876, datë 14.12.2016 "Për miratimin e tarifave të shpenzimeve administrative" si dhe Vendimit Nr. 662 datë 21.09.2016 "Miratimin e tarifave të përdorimit të ujit dhe të shkarkimeve të lëngëta ",Vendimit Nr.5 datë 16.02.2016, Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit UJOR”, Vendimit Nr.6 datë 16.02.2016, Për miratimin e rregullores “Për funksionimin e Agjensisë së Basenit UJOR”;

VENDOSI

Mos miratimin e lejes së ujit , për ambalazhim në shishe ose në enë, burimi uJOR, “Burimi Pocemit”, Fshati-Pocem Bashkia Ballsh, Qarku Fier subjektit "ADBERT -07" Sh.pk., me administrator Z. Lefter Malaj me këto të dhëna:

Koordinatat: X44 86 892; Y43 92 954; Z 50

Prurja mesatare : 840 l/sek

Prurja minimale: 695 l/sek

Sasia e ujit që do të përdoret 5 l/s

Ngarkohet ABU për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

PËRGJEGJËS I A.B.U “VJOSË”

Ilir PROFKA



KRYETAR I K.B.U “VJOSË”

Etjona HOXHA

